

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Mozaik

Mosha

Periudha zhvillimore (nga 5 deri në 10 vjet)

Vendi / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Qëndrueshmëri

Koha e nevojshme për përgatitje

10 minuta

Koha e nevojshme për realizim

30 minuta

Qëllimet

Fëmija të zgjedhë në mënyrë të pavarur materiale për realizimin e ideve të tij.

Rezultate të pritshme

Fëmija zgjedhë në mënyrë të pavarur materiale për realizimin e ideve të tij.

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Përgatitje e kokrrave të ndryshme në pjata të veçanta. Për këtë lojë mund të përdoren grosha, thjerrëzat, orizi, fjolla tërshëre dhe kokrra të tjera.

Pasi të vihen në tryezë mbi letër të bardhë prindi ose fëmija vizaton konture sipas dëshirës së vet (lule, flutur, kërmill e të ngjashme).

Instrukcione / kahje për lojën

Konturi i dhënë duhet të plotësohet me kokrra. Secili mundet sipas përzgjedhjes së vet të ngjesë kokrra të llojllojshme, të cilat duhet të vendosen njëra pranë tjetrës në kontur. Pasi të ngjiten kokrrat, në paletë vihen ngjyrat tempere dhe ngjyroset mozaiku.



Aktivitet / lojë

Fëmijës i shpjegohet procedura e punimit të mozaikut me kokrra të ndryshme. I jepet të zgjedh mes më shumë konturesh dhe prindi bashkë me fëmijën bën mozaik , me qëllim që ta nxis të jetë i durueshëm dhe ta plotësojë gjithë konturin me kokrra. Pasi të punohet mozaiku bëhet një pauzë e shkurtër. Pastaj përgatiten ngjyrat tempere dhe furçat. Fëmijës i shpjegohet procedura e pikturimit me ngjyra tempere, gjegjësisht se si ta përdor drejt furçën, ta lajë në gotën me ujë dhe ta shtrydh në shaminë e letrës para se të përdor tjetër ngjyrë temperi.

Shtojca

Materiale

/

Një fletë letre; ngjyra; kokrra(luledielli, fara kungulli, thjerrëza, oriz, kokrra tërshëre etj.); ngjitës; paletë për ngjyra; ngjyra tempere; gotë me ujë; shami letre; furçë

Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:

Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajn grafik: Katerina Nikolovska

Lekturë: Jana Mihajlovska

Përkthim: Agim Leka

